

PICASSO SIL-200



PËRSHKRIMI

Bojë plastike antibakteriale me veti të shkëlqyera higjienike falë teknologjisë Silver Complex, ideal për lyerjen e ambienteve spitalore

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Bardhësi superiore
- Sipërfaqe të lëmuar mat
- Mbulueshmëri e shkëlqyer
- Gjendet në 4 baza W, P, D dhe TR
- Punueshmëri dhe nivelim i shumë të nirë
- Ngjitje shumë e fortë dhe tharje e shpejtë
- Pranon 5000 cikle larjesh 30 ditë pas aplikimit
- Rezistencë të lartë ndaj larjes së shpeshtë, dhe mikro-organizmave

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Përdoret në të gjithë muret dhe tavanët e brendshëm, të rinj, të vjetër dhe të lyer më parë me bojë, me bazë çimento, gëlqere, gips, dhe në çdo lloj ambienti të brendshëm, dhoma gjumi, tualete, dhoma ndenjjeje, ambiente zyrrash, shërbimesh etj, kryesisht në ato ambiente ku kërkohet higjenë e lartë si, spitale, qendra shëndetësore, ambiente industriale, laboratorë klinikë, etj.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	Kopolimer akrilik
Densiteti EN ISO 2811-1	1,45±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	60%
Shkalla e hollimit	10 – 15%
Viskoziteti	110 ± 5 KU
Koha e tharjes mes dy shtresave	2 - 4 orë
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 1
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≤ 0.05
Aftësia mbuluese EN ISO 6504-3	≥ 99.5% Klasa I
Rezistenca ndaj larjes ISO 11998	Klasa I

UDHËZIME APLIKIMI

- Metoda e aplikimit: Furçë ose rrul.
- Hollimi: Rekomandohet të hollohet me 10-15% ujë përveç bazave D dhe TR që nuk sugjerohen të hollohen më shumë se 5% ujë.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet duhet të jenë të thara plotësisht, të pastra pa elemente që pengojnë ngjitshmërinë e bojës. Riparoni të gjitha plasaritjet dhe pjesët e dëmtuara duke përdorur produktet e linjës Deutschcolor, Vox 707, Glatte Spachtel, Spachtel Finish, etj. Më pas rekomandohet të aplikohet astar Macht Tiefgrund Wasser, i holluar me ujë në raportin 1:1 ose astar Macht Haftgrund i holluar me ujë në raportin 1:3. Gjatë aplikimit të astarit evitoni krijimin e një cipe e cila më pas krijon probleme në lidhjen e bojës me suportin.

PAKETIMI

3 lt, 10 lt

RUAJTJA

36 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që sipërfaqet e lyera të mos lahen deri në 30 ditë pas aplikimit.
- Në sipërfaqe të betonit të freskët produkti rekomandohet të aplikohet të paktën pas 30-40 ditësh.

